



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislacioni IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme

Mbledhja nr. 47

Prishtinë, më 23 janar 2013, në orën 11:30

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-2

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Albin Kurti, Enis Kervan, Sabri Hamiti, Skender Hyseni, Donika Kadaj-Bujupi, Emilija Rexhepi, Petar Miletij.

Mungoi: Hydajet Hyseni, Shaip Muja.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani, Manush Krasniqi dhe Gurjeta Zeka, praktikante.

Mbledhjen e kryesoi, Albin Kurti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d d i t e:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Planit dhe Programit të punës së Komisionit për vitin 2013;
3. Të ndryshme.

Albin Kurti - I njoftoi anëtarët e Komisionit se mbështetur në përfundimin e mbledhjes, që u mbajt më 16 janar 2013, është ftuar ministri Enver Hoxhaj, që të raportojë në këtë mbledhje. Përgjigjja është se ministri për shkak të agjendës së ngjeshur, nuk ka mundur t'i përgjigjet sot ftesës së Komisionit dhe propozoi për një takim në ditët në vijim, për të cilën ditë, thuhet se do të njoftohemi shumë shpejt.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës.

2. Shqyrtimi i Planit dhe Programit të punës së Komisionit për vitin 2013

Albin Kurti - Lidhur me planin dhe programin e punës së Komisionit për vitin 2013, tha se draf-plani dhe programi i punës së Komisionit për vitin 2013, pas mbledhjes së fundit të Komisionit, është plotësuar edhe me disa pika. Këto pika, kryesisht janë raportime nga zëvendëskryeministri z. Behgjet Pacolli, kryesuesi i Kosovës në bisedimet me Serbinë dhe drejtuesi i Akademisë Diplomatike z. Albert Prenaj.

Pas diskutimeve të deputetëve: Sabri Hamiti, Enis Kervan, Donika Kadaj-Bujupi, lidhur me Planin dhe Programin e punës për vitin 2013, kryetari konstatoi se Komisioni e nxori këtë

P ë r f u n d i m

Miratohet njëzëri Planin dhe Programin e punës së Komisionit për vitin 2013.

3. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit, lidhur me organizimin e Tryezës rajonale, tha se të ftuarve u janë shpërndarë ftesat për pjesëmarrje në këtë tryezë.

Anëtarët e Komisionit propozuan, që ky takim të organizohet në ndërtesën e Kuvendit, në sallën C-301, ndërsa sipas agjendës, vizita të organizohet, në qytetin e Mitrovicës.

Për pjesëmarrje në këtë tryezë, u propozua që të ftohen edhe:

- Përfaqësuesi Special i BE-së, në Kosovë,
- Udhëheqësi i Misionit të OSBE-së në Kosovë,
- Ministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme,
- Ministri i Ministrisë së Integrimeve,
- Kryetari i Komisionit për Integrime Evropiane,
- Ambasadorët e vendeve të Kuintit: SHBA-së, Francës, Gjermanisë, Britanisë së Madhe dhe Italisë.
- Ambasadorët e vendeve të rajonit.

Takimi përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Albin Kurti

